



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 561-35363 /2022

Klinë, dt.14/10/2022

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, më propozimin e zyrtares për barazi gjinore, kryetari i Komunës së Klinës mori, **këtë**:

V E N D I M

Për Themelimin e Këshillit Komunal për Persona më Aftësi të Kufizuara

1. THEMELOHET, Këshilli Komunal për Persona më Aftësi të Kufizuara në Komunën e Klinës, në këtë përbërje;
 - 1.1. Vitore Shala, zyra për barazi gjinore, kryesuese;
 - 1.2. Agron Bacaj, Drejtoria e Shëndetësisë, zëvendës kryesues;
 - 1.3. Halim Morina, OJQ "Handikos" anëtarë;
 - 1.4. Vitore Zefi, Qendra Rinore "Ardhmëria", anëtarë;
 - 1.5. Astrit Muhaxheri, Drejtoria e Arsimit, anëtarë;
 - 1.6. Fatjona Gashi, Drejtoria e Kulturës, anëtare;
 - 1.7. Silvija Rashkoviq, ZKKK, anëtarë;
 - 1.8. Shehrije Millaku, QPS, anëtarë;
 - 1.9. Ajet Sejdiu, Drejtoria e Financave, anëtarë.
2. Këshilli Komunal për Personat më Aftësi të Kufizuara ka për qellim të angazhohet në krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e kushteve të jetës për personat më aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, punësimit dhe parandalimin e çfarëdolloj diskriminimi të personave më aftësi të kufizuara.
3. Takimet e këshillit i udhëheq kryesuesja e këshillit për personat më aftësi të kufizuara në mungesë të së cilës udhëhiqen nga zëvendës kryesuesi.
4. Per zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Administratës, njësia për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut.
5. Ky vendim hynë në fuqi më rastin e nënshkrimit të tij nga kryetari i komunës.

Të njoftohen:

- Të përmendurit;
- Drejtoria e Administratës;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj